



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:023163

Datë: 04.07.2019

Numri i dokumentit: 00394053

**PKR.nr. 67/2018**

### **NE EMER TE POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË, - Departamenti i krime të Rënda**, Kryetari i Trupit Gjykuese Gjyqtari Shaqir Zika, me sekretaren juridike Bute Ramosaj, duke vendosur ne lenden penale kundër te pandehurit J.S. nga Gjakova, për shkak te veprës penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose ne posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 374 prg 1 te KPRK-se, dhe veprës penale lëndimi i rende trupore nga neni 186 prg 3 pika 1.3 lidhur me prg 1 pika 1.1. te KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Gjakovë, - Departamenti për Krime te Renda, PP/I.nr.215/2014, te dt. 22.12.2014, te mbajtur me dt. 28.06.2019, ne prezencën e te përfaqësuesit te akuzës Prokurorit te Shtetit Ali Uka, te akuzuarit J.S. dhe mbrojtësit te tij av.T.B. nga Gjakova, te dëmtuarit G.F., K- Gjakovë, publikisht dhe shpalli ketë me dt. 01.07.2019, ndërsa me dt. 04.07.2019 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. I pandehuri J.S.** nga i ati I. dhe ëma G. e gjinisë G., data e lindjes...,ne Gjakovë, ku dhe J., ne vendqëndrim ne Gjermani, ka te kryer shkollën e mesme, i martuar, i ati i dy fëmijëve Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal...

### **ËSHTË FAJTOR**

**I.** Se me parë ka siguruar dhe gjere me dt. 31.08.2014, ne Gjakove, konkretisht ne veturën e tij ka mbajtur ne posedim armë ne kundërshtim me Ligjin e aplikushem për armë dhe atë një revole te prodhimit Belg te kalibrit 9 mm, me numër serik ... me 6 fishekë, te cilën armë e ka përdorur ditën kritike .

**-Këso dore kane kryer veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 374 prg 1 te KPRK-se.**

**II.** Se me dt. 31.08.2014, rreth orës 16:00/h, ne Gjakovë, ne rrugën “N.T.” ne lokalin K.J. ka shkaktuar lëndime te renda trupore te dëmtuarit G.F., K- Gjakove, ne atë

mënyrë që pa asnjë fjalosje me të dëmtuarit G.i cili i kishte pasur borxhe shume prej 1.500€, i njëjti ka ardhur me veturë dhe nga vetura ka nxjerrë armën e prodhimit Belg te kalibrit 9 mm, me numër serik..., ka gjuajtur ne drejtim te këmbëve te dëmtuarit duke e qëlluar ne te dy këmbët nen gjunjë duke i shkaktuar lëndime te renda trupore me afër te përshkruar ne raportin e emergjencës Spitalit Rajonal “Isa Grezda “ ne Gjakove, nr. 11141 dt. 31.08.2018, dhe është larguar me veturë nga vendi i ngjarjes.

**-këso dore ka kryer veprë penale lëndim i rëndë trupore nga neni 186 prg 3 pika 3.1 lidhur me prg 1 pika 1.1 te KPRK-se.**

Andaj Gjykata ne mbështetje te neneve 3, 6, 17, 41, 43, 46, 73,74, 75, 76, 80, 83, dhe neneve 186 prg 3 pika 1.1 lidhur me prg 1 pika 1.1 te KPRK-se, dhe nenit 374 prg 1 të KPRK-së, dhe neneve 359, 365, 366, të KPPK-së, te akuzuarit .

## I SHQIPTON

**Të pandehurit J.S.** për veprë penale ne dispozitivin I te aktakuzës, për veprë penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 374 prg 1 te KPRK-se, dënim me gjobe ne shume prej 800 ( tete qind)€, e cila gjobe duhet te paguhet ne afat prej 15 ( pesëmbëdhjetë) dite, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i njëjti nuk e paguan gjobën te njëjtit i zëvendësohet dënimi me gjobe ne dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 40 ( katër dhjetë ) dite, duke llogaritur për çdo dite te burgimit shumen prej 20 ( njëzet )€.

Për dispozitivin II te akuzës për veprë penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 prg 3 pika 3.1 lidhur me prg 1. pika 1.1 dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 6 ( gjashte ) muajve, e ne te cilin dënim do te llogaritet koha e kaluar ne paraburgim nga dt. 21.11.2018, gjere me dt. 19.12.2018.

Ashtu qe te pandehurit dënimi i shqiptuar me burgim ne kohëzgjatje prej 6 ( gjashte ) muajve, ne te cilin dënim është llogaritur koha e kaluar ne paraburgim nga dt. 21.11.2018, gjere me dt. 19.12.2018, me pëlqimin e të pandehurit **është zëvendësuar dënimi me gjobe ne shume prej 3.500€**, e cila gjobe duhet te paguhet ne afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, po qe se gjoba nuk paguhet i njëjti do te vuaj pjesën e mbetur te dënimit me burgim ne kohëzgjatje prej 5 (pese) muaj e 3 (tre) ditë.

I shqiptohet dënimi plotësues i konfiskohet revoljja e prodhimit Belg kalibrit 9 mm, me numër serik...dhe 6 fishek kalibrit 9 mm.

I dëmtuari G.F., K- Gjakove, nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

I pandehuri obligohen qe ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 100 ( një qind) €, si dhe ne emër te Programit të kompozimit te viktimave te krimit shumen me nga 50€, të gjitha këto ne afate prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit nen kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakovë, - Departamenti Për Krime të Renda, ka ngritur aktakuzë kundër te pandehurit J.S. ka ngritur aktakuzës për shkak veprës penale mbajtje

ne pronësi, kontroll posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 374 prg 1 te KPRK-se, dhe veprën penale lëndimi i rende trupor nga neni 189 prg 3 lidhur me prg 1 te KPRK-se.

Pas dorëzimit te akuzës ne Gjykatë Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar dhe i pandehuri J.S. nuk ka qene i arritshme për Organet e ndjekjes ndaj te njëjtit është lëshuar urdhër arresti dhe letër rreshtimi vendor.

Ne baze te letër rreshtimit vendor i pandehuri J.S. është arrestuar ne Aeroportin e Prishtinë me dt. 21.11.2018, dhe ndaj te njëjti i është caktuar masa e paraburgimit ne kohëzgjatje prej 30 ( tri dhjete ) ditëve, e cila masë është zëvendësuar me dt. 19.12.2018, ne masën e dorëzarisë.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 28.06.2019, ku prezent ka qene përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Ali Uka, i akuzuari J.S. dhe mbrojtësi i tij av. T.B., i caktuar sipas autorizimit, si dhe i dëmtuari G.F..

Përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Ali Uka, para se te lexoi akuzën ka bërë ricilsimin juridik te veprës penale nga dispozitivi II i aktakuzës, ne vend te kualifikimit te veprës penale lëndimi i rende trupor nga neni 189 prg 3 lidhur me prg 1 te KPRK-se, komform nenit 3 te KPRK-se, qe duhet te aplikohet Ligjin me i favorshme për te pandehurin duke theksuar se duhet te jete “ me çka ka kryer vepër penale lëndimi i rende trupore nga neni 186 prg 3 pika 3.1 lidhur me prg 1 pika 1.1 te KPRK-se” i cili Ligj ka hyre ne fuqi me dt. 15.04.2019. dhe se për ketë vepër penale dënimi i përcaktuar është me i ulet se dënimi ng cilësimi juridike për vepër penale nga akuza. E duke u nisur nga parimi se duhet te aplikohet Ligji me i favorshëm për te pandehurin.

Pas leximit te aktakuzës nga ana e Prokurorit te Shtetit i pandehuri J.S.ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen sipas aktakuzës e te ri cilësuar ne këtë seancë te shqyrtimit fillestar.

Pas deklarimit te akuzuarit rreth fajësisë Kryetari i Trupi Gjykuese kërkoi mendimin nga Prokurori i Shtetit i cili ka deklaruar se këtu i pandehuri ne ketë seance te shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë për vepër penale nga aktakuza e te ri cilësuar për dispozitivin II te aktakuzës ne ketë seancë këtu pranimi i fajësisë mbështet dhe ne prova te siguruara gjate fazës se hetimeve e te propozuara ne aktakuze pranimi i fajësisë është bërë me vullnete dhe pa presion i njëjti ka kuptuar pasojat e pranimit te fajësisë, është konsultuar mjaftueshme me mbrojtësin e tij, andaj i ka propozuar Kryetarit te Trupit Gjykues te aprovoi pranimin e fajësisë se te pandehurit, gjate shqiptimit te dënimit ti ketë parasysh te gjitha rrethanat qe ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, pranimin e fajësisë.

Po ashtu i ka propozuar Trupit Gjykuese qe ndaj te njëjti ti shqiptohet dënimi plotësues ti konfiskohet revolja e prodhimit Belg kalibrit 9 mm, me numër serik ... dhe 6 fishekë te njëjtit kalibër.

I dëmtuari **G.F.** ka deklaruar se : pajtohet me pranimin e fajësisë së te pandehurit J.S. ai rastin ja ka falur ndaj te njëjtit nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, dhe nuk ka parashtruar kërkesën pasurore juridike dhe pas këtij rastin kam vazhduar te shoqërohem me te.

Mbrojtësi i te pandehurit **J.S. av. T.B.** ka deklaruar se: ne cilësinë e mbrojtësit deklaroi se këtu i pandehuri ka vendosur që te pranoi fajësinë për te dy pikat e aktakuzës për dispozitivin II të ricilësuar në këtë seancë nga Prokurori i çështjes, duke harmonizuar cilësimin me Kodin e Ri Penale të Kosovës, e cila dispozitë është me e favorshme për te pandehurin. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe i pandehuri është i interesuar që çështja të përfundojë sa më parë pasi që ky është i lidhur dhe me punë në botën e Jashtme edhe pse J. në Kosovë, dhe si do që të jetë rastin e vlerësimit të përgjegjësisë penale dhe sanksionit penal Gjykatës i lutem që të këtë parasysh se i pandehuri J. ka biografi të pastër penale, dhe se të dëmtuarit G.F. e ka pasur dhe me tutje e ka shokë dhe rastin ja ka falur ngjarja kritike ka qenë incident i rastit i cili për fat të mirë nuk ka pasur pasoja, siç deklaroi edhe vetë i dëmtuari se ai nuk ka ndonjë pasoje nga lëndimi i rastit andaj lus Gjykatën që dispozitivin I të akuzës të shqiptoi dënim me gjobë ndërsa për dispozitivin II të akuzës mendoi se ka kushte që të shqiptohet dënim me kusht dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit në kuptim të dispozitivit të KPRK-se. Me këtë rast Gjykata duhet të këtë parasysh se i pandehuri punon në Botën e Jashtme, është mbajtës i familjes i ati i dy fëmijëve, ka shprehur keq ardhjen i ka kërkuar falje shokut të vete këtu të dëmtuarit G., i cili rastin ja ka falur, dhe i njëjti i premtonte Gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

I pandehuri J.S. ka deklaruar se në tërësi e përkrah deklarin e mbrojtësi të tij dhe tani publikisht para Gjykatës i kërkoi falje këtu të dëmtuarit, shpreh pendimin e thellë për veprime që i ka ndërmarre dhe premtoi që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

Në shqyrtim fillestar, Kryetari i Trupit Gjykuës pas dëgjimit të palëve marrjes së mendimit të Prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit, të dëmtuarit G.F., ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, nga se ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt Kryetari i trupit Gjykuës ka konstatuar se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte të çështjes që përmban aktakuza, siç është raporti hetuesit policor D.B. me numër të dosjes 2014 – DB- 1509, të dt. 08.09.2014, raporti i oficerit H.T. i dt. 31.08.2014, foto albumi nga vendi i ngjarjes, raporti nga vendi i ngjarjes i dt. 31.08.2014, raporti i Spitalit Regjionale “ Isa Grezda “ në Gjakovë, me numër 11141 të dt. 31.08.2014, deklaratat e të dëmtuarit G.F., fletë lëshimi me epikriz të Spitalit Regjionale “ Isa Grezda “ në Gjakovë, me numër të amzës 351 të dt. 02.09.2014, shikimit të listës së armës së konfiskuar, me numër të rastit 2014- DB- 1509, të dt. 02.10.2014.

Andaj duke u bazuar në këto që janë cekur më lart, Kryetari i Trupit Gjykuës ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Se i pandehuri J.S. ka kryer vepra penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 prg 1 të KPRK-se, dhe veprën penale lëndimi i rende trupore nga neni 186 prg 3 pika 3.1 lidhur me prg 1 pika 1.1 të KPRK-se. në kohë vend dhe mënyrë siç është përshkruar në dispozitiv I dhe II të aktgjykimit.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj te pandehurit J.S., duke u bazuar në dispozitat e neneve 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-se, që ndikojnë llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin Gjykata ka marrë parasysh pranimin e fajësisë për të dy pikat e aktakuzës, sjelljen korrekte të tij, pendimin e tij të thellë, me herët i njëjti nuk ka qenë i gjykuar, është mbajtës i vetëm i familjes, i ati i dy fëmijëve, i dëmtuari nuk është bashkangjitur ndjekjes penale, nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar afati mbi

4 (katër) vite, andaj Gjykata te njëjti i ka shqiptuar dënimin me gjobe për dispozitiv I te aktakuzës ne shume prej 800€, ndërsa për dispozitivi II i ka shqiptuar dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 6 ( gjashte ) muajve, e ne te cilën dënim llogaritet koha e kaluar ne paraburgim, dhe pas komunikimit te aktgjykimit me kërkesën e mbrojtësit dhe pëlqimin e te pandehurit këtë dënim e ka zëvendësuar me dënim me gjobe ne shume prej 3.500 ( tre mije e pese qind ) €, Andaj dënimet e shqiptuara janë ne harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësisë penale për te pandehurin dhe Gjykata konsideron se me këto dënime mund te arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 te KPRK-se, i cili konsiston me parandalimin e te pandehurit nga kryerja e veprës penale ne te ardhmen.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues bazohet ne dispozitat e nënti 62 prg 1 pika. 2.7, lidhur me nenin 374 prg 3 te KPRK-se.

Vendimi për paushallin Gjyqësor bazohet ne dispozitat e nënti 450 prg 3 Kodit Procedurës, ndërsa lidhur me taksën për kompozimin e viktimave te krimit bazohet ne nenin 39 prg 3 nen prg 3.2 te Ligjit për kompozimin e Viktimave.

Nga arsyer at e lartë cekura dhe na zbatim te nënti 365 para 1 te KPPK-së, është vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË,- Departamenti për Krime të Rënda  
PKR.nr. 67/18, te dt. 04.07.2019,**

**Procesmbajtësja  
Bute Ramosaj**

**Kryetari i Trupit Gjyqësor  
Shaqir Zika**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankese ne afate prej 15 dite, nga dita e pranimit te aktgjykimit, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Numri i lëndës: 2018:023163  
Datë: 04.07.2019  
Numri i dokumentit: 00394053

Numri i lëndës: 2018:023163  
Datë: 04.07.2019  
Numri i dokumentit: 00394053